REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE

*Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Vogla dhe te Mesme*

**URDHER**
Nr. 110 Date 22/4 2003

**PER**
**NDRYSHIME NE AKTIN E THEMELIMIT DHE STATUTIN E SHOQERISE "TRANSNAFTA" SH.P.K. PATOS**

Drejtuar : Shoqerise "Transnafta" Sh.p.k. Patos

Duke marre parasysh pushimin e objektit te shoqerise "A.P.C". sh.a Tirane ne zbatim te Vendimit nr.28, date 16.01.2003 te Keshillit te Ministrave "Per likujdimin e Shoqerise "Albanian Petroleum Corporation" (A.P.C) Sh.a, Tirane ,

**KONSTATOVA**

Se ne baze te nenit 1 te Ligjit nr 8885, date 22.04.2002 "Per nje ndryshim ne Ligjin nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me ligjet perkatese; Ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare"; Vendimit nr.28, date 16.01.2003 te Keshillit te Ministrave "Per likujdimin e Shoqerise "Albanian Petroleum Corporation" (A.P.C) Sh.a Tirane, mbeshtetur ne nenin 23 te statutit te "A.P.C" sh.a, Tirane, me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise,

***Urdheroj* :**

I. Ndryshimin e Aktit te Themelimit te Shoqerise "Transnafta" Sh.pk. Patos si me poshte :

**Neni 2**, shfuqizohet.

**Neni 5,** i Aktit te Themelimit te Shoqerise "Transnafta" Sh.pk. Patos ndryshohet dhe behet si vijon:

Kapitali i Shoqerise "Transnafta" Sh.pk. Patos eshte 60.000.000 leke dhe i zoteruar teresisht nga Ministria e Ekonomise.

II. Ndryshimin e Statutit te Shoqerise "Transnafta" Sh.pk. Patos si me poshte :

**Neni 8 ndryshohet dhe behet si vijon :**

"Kapitali themeltar eshte i ndare ne 60.000 pjese te barabarta , secila me vlere nominale 1000 leke. Aksionet e Shoqerise "Transnafta " Sh.pk. Patos zoterohen ne masen 100% nga Ministria e Ekonomise".Te gjitha pjeset e barabarta zoterohen nga Ministria e Ekonomise.

III. Ngarkohet Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Vogla dhe te Mesme dhe Drejtoria Juridike te kryejne ne Gjykate proçedurat e depozitimit te ndryshimeve ne aktet e themelimit te shoqerise.

Ky urdher hyn ne fuqi ne fuqi menjehere

Arben MALAJ

MINISTER

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**MINISTRIA E EKONOMISE**
*Drejtoria Juridike*
*Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Vogla e te Mesme*

**URDHER**
Nr.277 Date 9.8.2004
**PER**
**NDRYSHIME NE STATUTIN E SHOQERISE "TRANSNAFTA" SH.P.K. PATOS**

Drejtuar : Shoqerise "**TRANSNAFTA" SH.P.K. PATOS**

Se ne baze te nenit 1 te Ligjit nr 8885, date 22.04.2002 "Per nje ndryshim ne Ligjin nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me ligjet perkatese; Ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare"; Vendimit nr.28, date 16.01.2003 te Keshillit te Ministrave, "Per likujdimin e e shoqerise " Albanian Petroleum Corporation" Sh. A Tirane, me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise,

Urdheroj :

I. Ndryshimin e Statutit te Shoqerise "Transnafta" Sh.p.k. Patos si me poshte :

**Ne nenin 1 shfuqizohet shprehja:**
"Shoqeria "Transnafta" Sh.p.k. Patos eshte shoqeri e kontrolluar nga shoqeria "APC" SH.A Tirane.

**Neni 12 riformulohet:**
Te gjitha kompetencat e asamblese se pergjithshme te parashikuar nga ligji nr 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" ushtrohen nga Ministri i Ekonomise me cilesine e ortakut te vetem.
**Neni 33 shfuqizohet**

II. Ngarkohet Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Vogla dhe te Mesme dhe Drejtoria Juridike te kryejne ne Gjykate proçedurat e depozitimit te ndryshimeve ne aktet e themelimit te shoqerise.

Ky urdher hyn ne fuqi ne fuqi menjehere

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E EKONOMISE TIRANE

Anastas ANGJELI
**MINISTER**
Ne mungese dhe me porosi
Ilir CIKO
**ZV/ MINISTER**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E EKONOMISË**
***Drejtoria e Privatizimit të Ndërmarrjeve dhe Shoqërive të Vogla e të Mesme***

AGJENSIA KOMBETARE E PRIVATIZIMIT TIRANE
NR. PROT 2653 DATË 15/06/2005

14.06.05

# URDHER

Nr. 178, Date 14.6.2005

## PËR
## PRIVATIZIMIN E PJESEVE TE KAPITALIT SHTETEROR TE SHOQËRISË "TRANSNAFTA" SH.P.K. PATOS,

*Drejtuar: Agjencise Kombetare te Privatizimit, Tirane*

Ne mbeshtetje te nenit 102, pika 4 te Kushtetutes te Republikes se Shqiperise, nenit 1 te Ligjit Nr. 8885, date 22.04 2002 "Per disa ndryshime ne ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare, ndryshuar me akte te tjera ligjore"; te Ligjit Nr. 8886, date 22.04.2002 "Per nje ndryshim ne Ligjin Nr. 8334, date 23.04.1998", te VKM nr. 30, date 16.01.2003 "Per privatizimin e shoqerise "Transnafta" Sh.p.k. Patos, te VKM Nr. 119, date 18.03.2000 "Per procedurat e privatizimit me ankand te paketave shteterore te aksioneve te shoqerive tregtare qe veprojne ne sektoret jostrategjike" i ndryshuar, regjistrimit te bere dhe llogaritjeve te rezultuara nga Agjencia Kombetare e Privatizimit derguar me shkrese nr. 1706, date 05.05.2005, me cilesine e ortakut te vetem te shoqerise "Transnafta" Sh.p.k. Patos,

**URDHEROJ :**

1. Te transferohet ne favor te punonjesve te shoqerise "Transnafta" Sh.p.k. Patos, pjeset e kapitalit shteteror ne masen 10,8535 % te kapitalit te shoqerise. Numri i pjeseve te barabarta te kapitalit qe privatizohet ne favor te punonjesve te kesaj shoqerie eshte 8,100 pjese me vlere nominale 1000 leke secila.

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

Anastas ANGJELI

MINISTER

REPUBLIKA E SHQIPERISE - MINISTRIA E EKONOMISE

15.06.05

# Protokolli i llogaritjeve per Ankandet

**Sektori i Statistikes dhe Marketingut  Dt.........**

Emri Shoqerise : **"Transnafta "shpk Patos**

| | |
|---|---|
| Kapitali themeltar:........................ | 74630000 Leke |
| Vlera nominale e nje pjese ............... | 1000 Leke |
| Vlera Totale e Bonove te Privatizimit Porositura nga punonjesit e shoqerise......... | 8100000 Leke |
| Vlera e lekeve nga vendimet e Komisionit Te kthimit dhe Kompesimit te Pronave Ishpronareve te porositura nga Ishpronaret...... | Leke |
| Paketa e aksioneve per punonjesit e shoqerise.. | 10.8535442 % |
| Numri i pjeseve per punonjesit e shoqerise... | 8100 nr |
| Paketa e pjeseve per ishpronaret e truallit.... | |
| Numri i pjeseve per ishpronaret e truallit. .... | nr |
| Numri i ortakeve punonjes te shoqerise..... | 115 nr |
| Numri i ortakeve ishpronare te truallit........ | nr |

Te dhenat analitike per çdo ortak jane pasqyruar ne fletet bashkelidhur te cilat fillojne me numrin rendor .................. dhe perfundojne me numrin rendor.....................

Drejtori

## *NDERMARRJET, BONOT dhe PJESA E PUNONJESVE*

| | *Kapitali* | *Paguar Gjithsej* | *Pjesa e Punonjesve* | *Nr. Pjeseve* |
|---|---|---|---|---|
| *"Transnafta "shpk Patos* | 74.630.000,00 | 8.100.000,00 | 10,8535442% | 8100 |